

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Christopher Hill: Thaçi nuk ka qenë i përfshirë në vepra të paligjshme
ADRESA	https://dosja.al/politike/denimi-i-ish-krereve-te-uk-se-christopher-hill-thaci-nuk-ka-qe-ne-i-perf-i514887
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 17:28:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 17:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0a6531b98714e4495f895c0c7fb4c7f6e9f9eb664e854326fa638963880d3c2a
TEKSTI	97a40d2378a2ec5bc2be2a506ec198f696c5370d78982ac2a1eccedb8d915479
PAMJA	8a5e67bf9ff0e535749ab9dc03bed2bf24f440585f7c7a3bb08364653420c389

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3ccf87239694fe2361cbdbd7cdb1931c12d3bf86a82ed0d3048844631a15edfc
E MËPARSHMJA	991fef65a1e4bf5f763b1c1a2d669aaa808dfcfd35516ec713c55d35c5e73ee
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3ccf87239694fe2361cbdbd7cdb1931c12d3bf86a82ed0d3048844631a15edfc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

1 ORE ME PARE

111 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Rama, jepe dorëheqjen

8 ORE ME PARE

Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

11 ORE ME PARE

"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë, të kërkojë rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

1 DITE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

Politike

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Christopher Hill: Thaçi nuk ka qenë i përfshirë në vepra të paligjshme

Hill vlerësoi lart figurën e Hashim Thaçit, duke thënë se ai ishte një komandant i zoti dhe shumë i pjekur për moshën që kishte. Hill theksoi se nuk e beson se Thaçi është përfshirë në vepra të paligjshme.



18 Shtator 2026, 19:20
Nga E. D



Christopher Hill

TIRANË- Ish-i dërguari i SHBA-ve në Kosovë Christopher Hill ka komentuar dënimin me 81 vite burg për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në një intervistë në Klan News, Hill vlerësoi lart figurën e Hashim Thaçit, duke thënë se ai ishte një komandant i zoti dhe shumë i pjekur për moshën që kishte.

Hill theksoi se nuk e beson se Thaçi është përfshirë në vepra të paligjshme. Më tej ai vlerësoi se populli shqiptar nuk duhet që të ketë mllef, por shpresë tek fjala e Apelit të Hagës.

"Hashim Thaçi ishte një personalitet dhe tepër i pjekur për moshën që kishte. Thaçi e kuptoi se Kosova duhet të ishte në një pozitë më të mirë dhe e kam vlerësuar gjithmonë atë. Unë nuk e besoj se ai është përfshirë në krime. Nuk e kam ndjerë nocionin se Thaçi të jetë përfshirë në vepra të paligjshme. Unë do të apeloja që të mos ketë mllef për këtë vendim. Duhet të shohim përpara dhe të kemi shpresë se vendimi i Apelit do të jetë në favor të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", nënvizoi Hill.

Hill u pyet nëse ekzistojnë realisht gjasat për shpërbërjen e kësaj gjykate, ndërsa tha se kësaj pyetjeje do duhet t'i japë përgjigje një ekspert i çështjes së të drejtës ndërkombëtare. Ai theksoi se në këtë fazë është e rëndësishme që avokatët e mbrojtjes të planifikojnë hapat e ardhshëm të procesit.

"Jeni duke pyetur një diplomat për një pyetje ligjore dhe do ju kërkoja që të flisni më mirë me një jurist të çështjeve të të drejtës ndërkombëtare. Përgjigjja ime është: Nuk e di, vërtet nuk e di. Ajo çka unë di, është nevoja për avokatët e palës mbrojtëse, që të planifikojnë hapat e tyre të radhës. Unë di po ashtu se duhet të kemi një zgjidhje të kësaj situatë, të cilën do e shikojmë si drejtësi, e cila do jetë në përputhje me faktet. Shpresoj se kjo të ecë përpara në mënyrë pozitive dhe ashtu si njerëz të tjerë edhe unë jam shumë i zhgënjyer me vendimin e marrë nga Gjykata Speciale vitet e fundit," tha ai.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 20:00

FOTO/ Aksidenti në Athinë,
këta janë tre të rinjtë që
humbën jetën tragjikisht

POLITIKE 18 SHTATOR 2026, 19:20

**Dënimi i ish-krerëve të UÇK-
së, Christopher Hill: Thaçi nuk
ka qenë i përfshirë në vepra të
paligjshme**

Hill tha se mërztitja dhe zhgënjimi janë pasoja të natyrshme të një vendimi të tillë, ndërsa shprehu empatinë e tij ndaj personave që e konsiderojnë vendimin të gabuar. Ai u bëri thirrje qytetarëve që të fokusohen më shumë te mërztitja sesa te zemërimi, duke nënvizuar rëndësinë e hapave që duhet të ndërmarrë pala mbrojtëse.

Hill theksoi se vëmendja duhet të përqendrohet te ajo që duhet të bëjë pala mbrojtëse, te veprimet dhe rruga që duhet ndjekur në vijim, si dhe te rezultati më i mirë për personat në Kosovë. Në fund, ai tha se nuk e sheh si të dobishëm zemërimin dhe mllëfin ndaj organizatave ndërkombëtare.

"Unë mendoj se të qenurit i mërztitur dhe i zhgënjyer janë pasoja të natyrshme të këtij vendimi. Unë shpreh empatinë time ndaj këtyre njerëzve, të cilët mendojnë se ky është vendim i gabuar. E kuptoj shumë mirë mllëfin dhe zemërimin e tyre, e kuptoj shumë mirë barrën shumë të madhe. Unë doja t'u thosha njerëzve që të qëndroni më shumë te pjesa e mërztitjes sesa të pjesa e zemërimit. Ajo që duhet të bëjnë njerëzit është se çfarë duhet tani për palën mbrojtëse si dhe cili është veprimi dhe rruga e duhur që duhet ndjekur nga pala mbrojtëse dhe po ashtu cili është rezultati më i mirë për personat në Kosovë dhe nuk mendoj se zemërimi dhe mllëfi kundrejt organizatave ndërkombëtare...nuk mendoj se ky zemërim është i mirë", tha ai.

Hill theksoi gjithashtu se kur ka qenë në Kosovë në vitet 1998-'99' situata në terren ishte e rëndë. Ai tha se Thaçi nuk ka pasur komandim të përgjithshëm të UÇK-së dhe se vetë Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ishte një ushtri e rregullt, por më shumë një përfaqësi njerëzish, që i bashkonte dëshira për liri e pavarësi të Kosovës. Sipas tij, situata nga gjenocidi serb ishte kaq e rëndë, sa zgjidhja ishte e detyruar të ishte me bombardime.

Gjykata e Hagës dënoi me 81 vite burg ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në shkallën e parë të gjykimitt. Hashim Thaçi u dënua me 25 vite heqje lirie, Jakup Krasniqi po me 25 vite, Kadri Veseli me 18 vite burg dhe Rexhep Selimi me 13 vite./Dosja.al

christopher hill

Sondazh

Poll

Politike

18 Shtator 2026, 18:20

BE-ja i përgjigjet Kurtit dhe Ramës për vendimin e Hagës: Specialja jep drejtësi të paanshme

foto ilustruese BRUKSEL- Bashkimi Evropian i është përgjigjur kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, dhe kryeministrit Edi Rama, ...

Akuza për vrasjen e Behajdin Allaçit/ Reagon avokati i Thaçit: Prova jashtëzakonisht të brishta dhe të pakonfirmuara

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 10:36

“O Hashim ti ku je, UÇK-në këtu e ke”/ Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit (VIDEO)

më të klikuarat

EKSKLUZIVE/ Erion Veliaj del nga qelia, kryebashkiaku shtrohet në spitalin Salus

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti European i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditit Latinopoulou

Takimi sekret në Buenos Aires/ Mediat urugaiane: DEA paralajmëron përparimin e mafies shqiptare në rajon

Pagat e magjistratëve/ Shefja e Thesarit, Tiranë: Kreva pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoj Malaj...

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow..

Politike
18 Shtator 2026, 16:00

EKSKLUZIVE/ Erion Veliaj del nga qelia,
kryebashkiaku shtrohet në spitalin Salus

Politike
18 Shtator 2026, 15:21

"Nuk do t'ju prekim fitimet por..." / Rama:
Euro e dobët, duhet reflektim te çmimet

Politike
18 Shtator 2026, 15:03



Rama takime me furnitorë: Po fitoni më
shumë se ç'e mban zakoni i mirë

Politike
18 Shtator 2026, 14:58

Politike
18 Shtator 2026, 14:04

**"Korrupsioni shfaqet në mënyrë të përsëritur në
raportet KE"/ Media spanjolle: Të akuzuarit e
AKSHI-it thellojnë skandalin, zotërojnë kështjellë me
vlerën e milionave eurove**

Edi Rama SPANJA- Skandali i AKSHI-t vijon të tërheq vëmendjen e
mediave të huja, nisur nga ngjarjet e fundit të cilat lidhen ...

Gjykata e Lartë la në qeli Veliajn,
avokatët e huaj: Të drejtat kushtetuese
nuk mund të ekzistojnë vetëm në letër

Politike
18 Shtator 2026, 14:02

E trishtë! Deputeti i PS, Loer Kume humb bashkëshorten: Dashuria ime sot na la

Politike

18 Shtator 2026, 13:53

Pagat e magjistratëve/ Rama fton në takim përfaqësuesit e gjyqësorit: Nëse nuk vini, na takon t'iu...

Politike

18 Shtator 2026, 11:43

Pas vendimit të Hagës për katër ish-krerët e UÇK-së, PDK dorëzon sot në Kuvend nismën për ndryshimin e Ligjit për Specialen

Politike

18 Shtator 2026, 11:26

MË SHUMË



Protesta në Tiranë/ Nis marshimi drejt Kryeministrit, thirrje: Jepe dorëheqjen

Rama: Euro e dobët, duhet reflektim te çmimet

Zjarr në sektorin Rinia në Durrës, banorët dhe zjarrfikësit në luftë me flakët

Rama takime me furnitorë: Po fitoni më shumë se ç'e mban zakoni i mirë

Protesta në Tiranë/ Nis marshimi drejt Kryeministrit, thirrje: Jepe dorëheqjen

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.